

VENDIM
Nr.379, datë 8.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË LESKOVIK TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Leskovik të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 420 (katërqind e njëzet).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Leskovik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1,2,3,4,5,6	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
51, 52-60	PRONA QË PËRDOREN PËR STREHIM DHE MBROJTJES CIVILE	NË PRONËSI
398	SHËRBIM FUNERAL	NË PRONËSI
69-150 61-64,397	INFRASTRUKTURË (RRUGË VENDORE, LULISHTË DHE SHËRBIME PUBLIKE)	NË PRONËSI
151-396	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS (TROJE).	NË PËRDORIM
31, 32,33	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN SOCIALE.	NË PRONËSI
12,13,14	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE)	NË PËRDORIM
15,16,17,18	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA JOPRODUKTIVE)	NË PRONËSI